



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2024:003203
Datë: 17.09.2024
Numri i dokumentit: 06173077

C.nr.11089/23

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË -Departamenti i Përgjithshëm–Divizioni Civil, me gjyqtaren Fatbardha Uka Ibrahim, në çështjen juridike kontestimore të paditëses M.A., nga P., të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Hasan Haxhaj, avokat nga Glllogovci, kundër të paditurës Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës – SHSKUK, Qendra Klinike Universitare e Kosovës – QKUK, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensimin e pagës së 13-të , jashtë seancës gjyqësore, me datë 17.09.2024, jep këtë:

A K T G J Y K I M
P a s h q y r t i m

I. REFUZOHET NË TËRËSI si e pa bazuar kërkesëpadia e paditëses M.A., nga P., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës – SHSKUK, Qendra Klinike Universitare e Kosovës – QKUK, me seli në Prishtinë, që paditëses, në emër të kompensimit të katër pagave të 13-ta, t'ia paguaj shumen 1,700.00 €, me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke e llogaritur nga data e ushtrimit të padisë, e deri në përmbushjen definitive.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të kësaj procedure.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes përfaqësuesit të autorizuar, pranë kësaj Gjykate me dt.28.12.2023 ka parashtruar padi kundër të paditurës Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës – SHSKUK, Qendra Klinike Universitare e Kosovës – QKUK, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensimin e pagave të 13-ta. Në referatin e padisë ndër tjera ka theksuar se paditësja është e punësuar pranë të paditurës në vendin e punës "...". Tutje thekson se sipas Kontratës Kolektive Sektoriale, të lidhur në mes të Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës dhe Ministrisë së Shëndetësisë të Republikës së Kosovës, në cilësinë e autoritetit më të lartë menaxhues në sektorin e shëndetësisë, konkretisht kapitullit IV, që ka të bëjë me Stazhin e Punës, nenin 17 par.2 të kësaj Kontrate, paditësi ka të drejtën në kompensimin e pagës së 13-të për çdo vit kalendarik në vlerën e pagës bazë. Më tej thekson se meqenëse e paditura nuk e ka përmbushur detyrimin e saj lidhur me kompensimin e pagës së 13-të të paraparë me Kontratën Kolektive Sektoriale, e cila shërben si bazë juridike e mbështetjes së padisë. Mbi bazën e këtyre pretendimeve, ka propozuar pas administrimit të provave të merr aktgjykim me të cilin aprovohet kërkesëpadia dhe detyrohet e paditura që paditëses t'ia kompensoj katër paga të 13-ta paditëses me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke e llogaritur nga data e ushtrimit të padisë, e deri në përmbushjen definitive. Po ashtu i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës.

E paditura përmes përgjigjes në padi, të deponuar në Gjykatë me dt.04.07.2024, e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, si për nga baza ashtu edhe lartësia. Në përgjigje në padi fillimisht theksohet se kompensimi i pagës së 13-të nuk është paraparë me Ligjin e Punës Nr.03/L-212, ndërsa tutje është cituar neni 90 par.5 i këtij ligji, duke pretenduar se në rastin konkret e paditura SHSKUK nuk është palë nënshkruese e marrëveshjes në të cilën mbështetet kërkesëpadia e paditëses. Tutje e paditura i është referuar dispozitës nga neni 17 par.2 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë si dhe Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të dt.09.10.2023, duke vlerësuar se në mënyrën se si është formuluar dispozita e lartcekur, çështja e kompensimit të pagës së 13-të për punëtorët shëndetësorë është e kushtëzuar me mundësitë financiare të punëdhënësit, e në rastin konkret e paditura bazuar në buxhetin e ndarë për paga dhe mëditje nuk ka pasur mundësi për kompensimin e pagës së 13-të sipas kërkesës së paditëses. Bazuar në këto pretendime, i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave, kërkesëpadinë e paditëses ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar.

Lidhur me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

Me rastin e pranimit të përgjigjes në padi, gjegjësisht vlerësimi të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse e në lidhshmëri me vlerësimin e provave të bashkangjitura, kjo Gjykatë erdhi në përfundim se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, rrjedhimisht nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e një vendimi meritator mbi refuzimin e kërkesëpadisë pa caktuar fare seancë gjyqësore, në kuptim të dispozitës nga neni 399 par.1 dhe 2 të LPK-së, e cila përcakton: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritator me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia. Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura.”*

Nga provat e bashkangjitura në padi, Gjykatës gjeti se mes palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti që paditësi është në marrëdhënie të rregullt pune me të paditurën, e sistemuar në vendin e punës “...”. Kontestues nuk është as fakti se paga mujore bazë e paditëses për katër paga të 13-ta, konsiston në shumën prej 1,700.00 €. Faktet e tilla vërtetohen në bazë të Kontratës së Punës të datës 01.12.2010, si dhe lista e pagave me numër ..., të bashkangjitura në cilësinë e provave materiale në shkresat e lëndës.

Kontrata Kolektive Sektoriale, është lidhur ndërmjet Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, në cilësinë e përfaqësueses së punëtorëve shëndetësorë në njërin anë dhe Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Kosovës, në cilësinë e autoritetit më të lartë menaxhues në sektorin e shëndetësisë në anën tjetër. Kjo Kontratë ka hyrë në fuqi me dt.11.06.2018, me rastin e nënshkrimit nga palët, me afat 3 vjeçar të vlefshmërisë, gjegjësisht deri me dt.10.06.2021. Në këtë mënyrë, një periudhë e tillë e vlefshmërisë është në harmoni të plotë me dispozitën nga neni 90 par.4 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, e cila përcakton që: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet”*. Po ashtu, vlen të theksohet fakti se me dt.21.11.2022, Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar shkëputjen e kësaj Kontrate, edhe pse kontrata kishte skaduar. Një çështje e tillë është sqaruar përmes interpretimit të dhënë në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, GJ.A-Su.A 212/2023, të dt.09.10.2023, lidhur me zbatimin e Kontratës Kolektive lidhur me kërkesat e pagës së 13-të të punëtorëve të shëndetësisë. Në linjë të njëjte është dhënë sqarimi edhe në bazë të Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës GJ.A-Su.A 40/2023, të dt.27.02.2023, ku në pjesën e

parë, pikën V të këtij Mendimi sqarohet se: "*Kontrata Kolektive Sektoriale e lidhur me datë 12.06.2021, e nënshkruar nga Organizatat e të punësuarve (Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës), si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, (Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës), (në tekstin e mëtejme: Kontrata Kolektive Sektoriale e datës 12.06.2021) aplikohet për periudhën kohore 11.06.2018 - 10.06.2021."*

Çështja e kompensimit të pagës së 13-të për çdo vit kalendarik, është e përcaktuar me dispozitën nga neni 17 par.2 të kësaj Kontrate, ku parashihet që: "*Punëmarrësi ka të drejtë në kompensimin e pagës së 13 (trembëdhjetë) për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit.*" Nga interpretimi i dispozitës së lartëcekur të nenit 17 par.2 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë, rrjedh se kemi të bëjmë me detyrim të kushtëzuar, që nënkupton se e drejta e paditëses si punëmarrës i të paditurës për të realizuar një kompensim të tillë nga marrëdhënia e punës është thelbësisht e lidhur nga mundësitë buxhetore të kësaj të fundit. Në këtë mënyrë, bazuar në rregullat mbi barrën e të provuarit në procedurë (neni 7 lidhur me nenin 319 i LPK-së), u takon secilës nga palët ndërgjyqëse që në çdo fazë të procedurës, përmes provave të bashkangjitura t'i provojnë pretendimet e tyre. Palës paditëse i takon që ta provojë se i përmbushë kushtet e përcaktuara nga dispozita e lartëcekur për të realizuar të drejtën në kompensimin e pagës së 13-të për vitet kalendarike përkatëse. Në anën tjetër, e paditura në cilësinë e punëdhënësit në çdo fazë të procedurës mund të deklarohet me prova konkrete lidhur me çështjen e mundësive buxhetore për përmbushjen e obligimit në fjalë. Në funksion të një interpretimi të tillë, Gykata iu referua Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, G.J.A.Su.A.nr.212/2023, të datës 09.10.2023 për zbatimin e Kontratës Kolektive Sektoriale lidhur me kërkesat e pagës së 13-të të punëtorëve të shëndetësisë.

Me rastin e parashtrimt të përgjigjes në padi, e paditura në cilësinë e provave materiale ka bashkangjitur njoftimin me numër protokollit, të dt.27.10.2023, si dhe njoftimin me numër protokollit, të dt.21.12.2023.

Në bazë të njoftimit me numër protokollit, të dt.27.10.2023, rezulton që z. - në cilësinë e shefit të sektorit për Buxhet dhe Financa në QKUK, i është drejtuar Zyrës ligjore të këtij institucioni, në përgjigje lidhur me kërkesën për kompensimin e pagës së 13-të. Në këtë shkresë, i njëjti i është referuar dispozitës së nenit 17 par.2 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë, duke e vënë theksin në faktin se Qendra Klinike Universitare e Kosovës, deri tani në asnjë vit nuk ka pasur mundësi buxhetore të realizojë këtë kompensim, sepse përherë kanë pasur buxhet të mangët, sidomos për pagesën e pagave të rregullta të stafit. Njoftimit në fjalë i është bashkangjitur edhe një pasqyrë e ecurisë së buxhetit dhe pagesave të stafit për vitet 2018-2022 si dhe lista për buxhetin e miratuar për vitet përkatëse.

Nga njoftimi me numër protokollit, i dt.21.12.2023, Gjykata vëren se z. - Drejtor Financiar/Ekspert i Ekonomisë dhe Menaxhmentit Shëndetësor, i është drejtuar Zyrës ligjore të SHSKUK-së, duke e informuar që në referim të tabelave ndër vite e njofton këtë zyre lidhur me buxhetin dhe mungesat në kategorinë e pagave dhe mëditjeve, duke shtuar se edhe përkundër planifikimeve, SHSKUK si organizatë buxhetore asnjëherë nuk kanë disponuar me buxhet të mjaftueshëm deri në fund të vitit për të plotësuar nevojat për këtë kategori, ku në tre mujorin e fundit - TM3 të çdo viti kalendarik vazhdimisht kanë pasur deficit në paga dhe janë plotësuar nga Ministria e Financave për mbulimin e pagave të rregullta. Tutje në këtë shkresë theksohet se me buxhet fillestar me tabela ilustron buxheti i aprovuar sipas ligjit të buxhetit dhe ligjit të financave publike, ndërsa buxheti i shpenzuar dhe diferenca tregojnë se në çdo fund vit edhe sa mjete shtesë është dashur të shtohen për plotësimin e nevojave të domosdoshme, në mënyrë që stafi të përfitojë pagat në kohë.

Në bazë të vështrimit të këtyre provave materiale, Gjykata vëren se në kuadër të komunikimeve të nivelit të brendshëm të të paditurës është shqyrtuar çështja e kompensimit të pagave të 13-ta për të punësuarit, pra një iniciativë e tillë nuk ka munguar. Megjithatë, nga përgjigjet e dhëna nga personat përgjegjës është vënë në pah fakti se e paditura si organizatë buxhetore e pavarur është ballafaquar me vështirësi në përmbushjen e të gjitha detyrimeve që kanë të bëjnë me pagat dhe mëditjet e punëtorëve, si pasojë e së cilës janë plotësuar nga Ministria e Financave për mbulimin e këtyre shpenzimeve. Në këtë kuptim, e njëjta ka arritur ta provojë faktin se nuk gëzon mundësi të mjaftueshme buxhetore në raport me përmbushjen e obligimit për kompensimin e katër pagave të 13-ta, që njëherit paraqesin objekt shqyrtimi të kësaj çështje kontestimore.

Një fakt i cili nuk duhet anashkaluar ka të bëjë me atë se planifikimi dhe ndarja buxhetore për institucionin përkatës përfshin vetëm shpenzimet dhe pagat e rregullta, ndërsa kompensimet e pagave të 13-ta për të punësuarit nuk hyjnë në kuadër të këtij planifikimi, e si pasojë realizimi eventual i kërkesave të tilla do t'i tejkalonte mundësitë e të paditurës në raport me përmbushjen e obligimeve ndaj të punësuarve të saj. Dispozita në të cilën paditësi e ka mbështetur themelësinë e kërkesës së tij është e karakterit fakultativ, e në rast se do të kishte karakter obligativ, pikëpamjet e Gjykatës do të ishin thelbësisht të ndryshme. Si rezultat i një interpretimi të tillë, Gjykata vlerëson se nga faktet e treguara në padi rezulton që palës paditëse i mungon themelësia e kërkesëpadsisë në këtë çështje juridike dhe bazuar në një bindje të tillë, nuk është fare e nevojshme të caktohet seancë gjyqësore, pasi ndërmarrja eventuale e këtij veprimi nuk do të ndryshonte pikëpamjet e Gjykatës.

Mbi këtë bazë, Gjykata vendosi decidivisht si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditëses, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës – SHSKUK, Qendra Klinike Universitare e Kosovës – QKUK, me seli në Prishtinë, që paditëses, t'ia kompensoj katër pagat e 13-ta, me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke e llogaritur nga data e ushtrimit të padisë, e deri në përmbushjen definitive.

Vendimin që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta të procedurës, nga pika II e dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore nga nenet 450 lidhur me nenin 463.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Mbi bazën e të lartcekurave, në mbështetje të dispozitave nga nenet 160 dhe 399 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË,
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.11089/23 datë 17.09.2024**

**Gjyqtarja
Fatbardha Uka Ibrahim**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.